



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	E Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Nëntor 2022
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Prof.ass. Izet Sadiku
Përgatitur	Drejtoria e Shëndetësisë

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.

- Me 24 nëntor kuvendi i Prishtinës ka themeluar Poliklinikën Stomatologjike, e cila është institucioni i parë i nivelit të mjeksisë sekondare në Kosovë.
- Janë blerë pesë vetura për shërbimin kronik, prej të cilave katër është sjellur në nëntor dhe një do të silllet në dhjetor.
- Janë blerë 100.000 euro pajsije mjekësore,
- Është blerë një mamograf për institucionete KPSH në kryeqytet.

- Nga 1 mars 2022, kur është rritur numri i ekipeve profesionale për shërbim kronik, i cili tashmë funksionon me 4 ekipe gjatë ditëve të punës dhe 2 ekipe gjatë vikendit, janë dyfishuar edhe numri i shërbimeve të tilla;
- Janë relaizuar 29866 shërb dhe 7462 vizita mjekësore janë realizuar për 9 muaj në shërbimin kronike.
- Lansohet projekti mbi menaxhimin e autoambulancave QMU i cili projekt krijon parakushte për veprim më të shpejt dhe më efikas te pacientët.
- Përfaqësues nga Project Cure dhe populli amerikan, vlerësuan situatën në terren rreth mundësisë së donacioni në mjekësinë familjare në kryeqytet;
- Monitorim i aktivitetit – Përmirësimi i infrastrukturës në objekte KPSH – të cilat u realizuan në objektet QKMF, QMF 1 dhe AMF Studentëve;
- Vazhdon vaksinimi i qytetarëve në lagje të gjithsecilit me vaksinë grip sezonal;
- Është realizuar java botërore e diabetit me moton: “Edukuho, Nëse sot jo, KUR?;
 - Bashkëpunim me shoqatën e endokrinologëve dhe dialektologeve; - ligjërata me tema ditore për 5 ditë radhazi;
 - Aktivitet ne shesh matja e nivelit të glikemisë për qytetarët e rastit;
 - Matja e nivelit të glikemisë për qytetarët në qendrat ditore të të moshuarve;
 - Edukim dhe promovim shëndetësor në shkolla;
 - Aktivitet fizik ecje në parkun e Gërmisë qytetarët së bashku me kryetarin ZKryetari Përparim Rama; për të vazhduar me menu të shëndetshme mëngjesi;
 - Ndriçim i objektit Sahat Kulla dhe Termokos me ngjyrë të kaltër e cila simbolizon komunitet për ditën ndërkombëtare të diabetit;
- Me moton: Së bashku të parandalojmë rezistencën antimikrobike shënohet java botërore e vetëdijesimit për antimikrobikë;
- Aktiviteti ne Shesh u realizua ne Tende çdo dite te javës prej orës 9 00-13 00 . Aktiviteti u mbajt nga studentet e kolegjeve private dhe studenteve te drejtimimit te infermierisë nga Universiteti i Prishtinës. Aty u realizuan ne total 950 matje te vlerave te glikemisë;
- Për shërbime shëndetësore cilësore dhe përmirësim të kushteve të punës profesionale realizohet furnizimi me pajisje mjekësore;
- Për nder të javës botërore të diabetit organizohen aktivitete të ndryshme:
 - Qendrat ditore për të moshuar nga ekipet QMF1, QMF5, QMF8 dhe QMF 11 ku ne total ishin prezent 75 pjesëmarrës, 65 prej tyre iu është bere matja e glikemisë.
 - Ligjërata ne disa prej shkollave te Prishtinës nga ekipet e QMF2, QMF6, QMF7, QMF9, QMF10, QMF Mat, QMF Mati1, QMF Hajvali me c' rast ne total u përfshin ne aktivitet 223 pjesëmarrës nga stafi arsimor ndërsa u testuan 152 prej tyre;

- Aktivitet brenda Qendrës familjare mbajti QMF Besi dhe QMF Bardhosh (ne pamundësi realizimi te aktivitetit ne shkolla) ku u përfshinë ne total 14 pacientë dhe u bene 14 matje te vlerave te glikemisë;
- QKMF ne bashkëpunim me QKUK/ reparti endokrinologjisë realizoj ligjërata edukative për pacient gjate tere javës ne sallën e QKMF-se e cila u finalizua me ligjëratën e ditës se premte ku pjesëmarrës ishin rreth 65 pacient me diabet;
- Po ashtu, u organizua një ecje ne parkun e Gërmisë me te gjithë pjesëmarrësit e këtyre ligjëratave. Prezent ne ecje ishin diku rreth 65 persona.
 - Si shërbim shëndetësor të nivelit sekondar votohet në Kuvend Komunal themelimi i Poliklinikës stomatologjike;
 - Takim publik për shëndetësinë e Kryeqytetit – banorët e Dardanisë; temat:
 - Shërbimet e Kujdesit shëndetësor në lagjen tuaj si dhe
 - Regjistri i banorëve në kujdesin parësor shëndetësor;
 - Shqyrtim i programeve dhe projekteve te AMC-se;
 - Analizim i planit te programit “Vizita ne shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët 0-3 vjeç”;
 - Kontakt te vazhdueshëm me **AMC-ne** (Action for Mothers and Children) dhe UNICEF për programin “Vizita ne shtëpi për nena dhe fëmijë”;
 - Bashkëpunim me AMC dhe me stafin e repartit te gjinekologjisë ne QKMF Prishtine për programin “Klasa për Nena”, organizim i trajnimit për mamitë si dhe për projektin “Group care ne 1000 ditët e para”;
 - Shqyrtim i planit te Fizibilitetit te Spitalit të Prishtinës;
 - Monitorim i aktivitetit për furnizim me material shpenzues në QKMF nga kompania Biohit, Madekos, Keisi, Medilab,
 - Monitorim i aktivitetit për furnizim me material shpenzues në QMU nga kompania Madekos;
 -
 -
 - Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja si dhe në QMU;
 - Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH;
 - Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë;

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë

- Përgatitje teknike, fillimin e renovimeve dhe përmirësimit të hapësirave së bashku me profesionistët nga NPB;
- Monitorim profesional i KPSH-së, në çdo kohë;
- Fillojnë vizitat sistematike në SHMU dhe SHML për nxënësit e klasave të I,V dhe IX me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të sëmundjeve por edhe promovimit dhe edukimit shëndetësor;

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues

- Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente si rezultat e pandemisë globale;
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente si rezultat e pandemisë globale;

4. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës

4.1.1. Buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese

- Përgatitjen dhe dorëzimin e listës (subvencionet) për pagesë në MEF-ve gjithësej 147 persona.
- Arkivimi i faturave financiare
- Zotimi dhe ekzekutimi i obligime gjithësej 154 fatura
- Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve profesionale (QMU-QKMF) lidhur me përgatitjen e dokumenteve dhe shpenzimeve të buxhetit, bashkëpunim profesional me Drejtorin e financave, me zyre të prokurimit rreth procedurave të ndryshme si dhe me MEF-ve
- Mbikëqyrjen, monitorimin e buxhetit dhe shpenzimeve në bazë të kërkesave
- Deklarimin e obligimeve me të vjetra se 30 ditë dhe përgatitjen e deklaratave të disponueshmërisë
- Pune me pale rreth kërkesave të tyre për pagës
- Përgatitjen e raporteve javore

- Me datë 15.11.2022 ne cilësinë e anëtares kemi mbajtur takim me Komision Komunal për Ri integrim për shqyrtimin e kërkesave të riatdhesuarve për ri integrim
- Pune shtesë për Drejtorin e Mirëqenies Sociale- zëvendësim i zyrtares financiare deri sa të kthehet nga pushimi I lindjes

4.1.2. Takimet me palë

Informim i përditshëm i qytetarëve

4.1.3. Takimet me institucioneve tjera

- ✓ Përfaqësues Project Cure;
- ✓ Menaxhment QKMF dhe QMU;
- ✓ Media lokale;

4.1.4. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë

- Takim publik për shëndetësinë e Kryeqytetit – banorët e Dardanisë; temat:
 - Shërbimet e Kujdesit shëndetësor në lagjen tuaj si dhe
 - Regjistri i banorëve në kujdesin parësor shëndetësor;

4.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

4.1.6. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

4.1.7. Përfitues te subvencioneve

Në periudhë raportuese 302 mbesin në rishqyrtim kurse 30 kërkesa refuzohen.

4.1.8. Takime të tjera

5. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

Mungesa e punëtorëve në DSH dhe KPSH;

6. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Monitorim i përditshëm të personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale.

7. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme

- Realizimi i detyrave të ndryshme administrative;
- Njoftime të ndryshme zyrtare telefonike me qytetarë;

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

RRJEDHA E PUNËS

Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:

Të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare me orar të rregullt.

Procesi i vaksinimit në Njësinë e Vaksinimit në QKMF Prishtinë nga datë 01.11.2022 deri më datë 30.11.2022 ka filluar punën në ndërrimin e paradites nga ora 07:00 deri në orën 13:00 dhe në ndërrimin e pasdites nga ora 13:00 deri në orën 20:00 me aplikim të dozës së parë, të dytë, të dozës së tretë ,dozës së katërt dhe dozës pediatrie me vaksinën Pfizer BioN/Tech kundër Covid-19.

Nga data 01.11.2022 deri më datën 30.11.2022 në Njësinë e Vaksinimit në QKMF sipas të dhënave janë realizuar 52 vakcina Pfizer BioN/Tech. Nga data 31.11 2022 vaksinimi kundër COVID 19 me vaksinën Pfizer është organizuar edhe në 10 QMF të tjera ku ka njësi të vaksinimit.

Totali i vaksinës kundër gripit sezonal 9,581

Me datë 01.11.2022 kanë filluar vizitat sistematike .Në vizita përfshihen klasë e para , pesta dhe të nënta. Vizitat do të realizohen në të gjitha shkollat e Komunës të Prishtinës. Ekipi përbëhet nga Mjeku Familjarë dy infermiere, stomatologu dhe ass I stomatologjisë. Punën kanë filluar shtatë ekipe vazhdojmë pastaj me ekipet tjera.

Laboratori Qendror- QKMF- Prishtinë

Muaji Nëntor - 2022	total	patologji
Pacienta te regullt	2319	596
D-dimer	156	116
Rapid-test-agj	5	1

TSH,T3,T4 dhe PSA	223	44
Tot.pacienta	3087	757
Participus	746	2056 euro

DSM numri i vizitave mjekësore 599 vizita , pacient me TBC aktiv 141 , raste të reja me TBC 20 pacient.

Poliklinika e Stomatologjisë dhe Shërbimi stomatologjik orari i punës (07:00-15:00).

Shërbimi stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7.

Numri i pacientëve në Shërbim Stomatologjik të QKMF-Prishtinë gjatë muajit Nëntor është 10,017 pacient.

Numri i grafive në Shërbimin e rëntgenit në Poliklinikën Stomatologjike QKMF është 483 Shërbimi Pediatrik orari i punës (07:00-13:30 dhe 13:30-20:00) kujdestaria e rregullt në Pediatri organizohet (e shtune nga ora 08:00-14:00 dhe e diel nga ora 08:00-14:00). Kujdestaria festive në Pediatri organizohet me orar të njejtë pune sikur kujdestaria e rregullt mujore. Këto ndryshime në orar janë bërë për shkak të mungesës të stafit-Pediatreve.

Numri i vizitave mjekësore në Shërbimin Pediatrik gjatë muajit Nëntor është 3,303 Echo të kokërdhokullave 79 pacientë.

Radiologjia orari i punës në funksion për momentin janë dy njësi radiologjike në QKMF,QMF V. Gjatë muajit Nëntor janë realizuar 1,669 Radiografi 313 Mamografi 415 Echo e Abdomenit 170 Echo të gjirit.

Shërbimi kronik punon me orar të rregullt (07:00-19:00) çdo ditë pune, punohet edhe vikendeve dhe ditëve festive. Puna organizohet me dy ndërrime paradite dhe pasdite me nga dy ekipe (një mjek dhe një infermiere) . Numri i vizitave në shërbim kronik për muajin Nëntor ka mbërri në 862 vizita mjekësore .

Për momentin i kemi në mbështetje ndërrimet e natës në 3 Qendrat e Mjekësisë Familjare të cilat funksionojnë 24/7, mbështetja fillon nga ora 19:00-24:00 sa herë paraqitet nevoja qoftë për mjek po ashtu edhe për infermier. Mbështetja vazhdon edhe në Shërbimin Kronik si dhe Mjekësi Familjare e po ashtu edhe në AMF Bardhosh.

Në Barnatoren Qendrore QKMF – Prishtinë gjatë muajit Nëntor 2022 shërbim kanë marr 1,830 pacient insulinave .

Numri i pacientëve që kanë kërkuar transport për Hemodializë është 57

AMF të (punon çdo ditë pune nga ora 07:00-14:00 mjeku dhe infermieri Shkabaj, Mramor, Lukar,Barilevë, Bardhosh).

Keqekollë punon tre ditë në javë (hënë, mërkurë, premte).

Koliq (të martën mjeku ndërsa infermieri çdo ditë).

Dabishevcë (e enjte ekipe komplet).

Viti Bullaj nuk punon për momentin.

Slivovë (e marte dhe e enjte mjeku punon ndërsa infermieri çdo ditë).
 Sharban, Rimanishtë, Kishnicë (infermieri çdo ditë dhe higjienisti)
 Aktivitetet e realizuara të ZHVP së Nëntor 2022

Data	Aktivitetet-Nëntor/ 2022
09.11.2022 16.11.2022	Ligjerata: " Obeziteti te Femijet " është mbajtur në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional ku kanë marrë pjesë 53 Mjek nga QKMF. Ligjëruese: Dr. Vjosa Mulliqi Kotori-Pediatër-Endokrinologe/QKUK
21.11.2022	Ligjerata: " Rezistenca ndaj antibiotikëve " është mbajtur në QKMF me rastin e javës botërore të rezistencës ndaj antibiotikëve ku kanë marrë pjesë 47 Mjek nga QKMF. Ligjërues: Prof. Dr. Lul Raka- Mikrobiolog/QKUK
22.11.2022 23.11.2022	Trajnimi 2 ditor: " Pakoja Minimale Fillestare e Shërbimeve (MISP) për Shëndet Seksual dhe Riprodhues (SHSR) " organizuar nga MSH në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës dhe me përkrahje nga UNFPA është mbajtur në QKMF ku kanë marrë pjesë 20 profesionist shëndetësor nga QKMF.
30.11.2022	Ligjerata: " Studim rasti-Angioedema hereditare " është mbajtur në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional ku kanë marrë pjesë 35 Mjek nga QKMF. Ligjërues: Dr. Rushit Ismajli-spec. i Mjekësisë Familjare/QKMF

Aktivitetet e realizuara nga Qendra e Trajnimit për Infermieri Familjare ZHVP-së Gjatë muajit Nëntor në Zhvillimin e Vazhdueshëm Profesional janë mbajtur 17 ligjerata me temën "Kujdesi Antenatal". Kanë marrë pjesë gjithsejtë 238 pjesëmarrës, Infermier/e, mami, laborantët, teknikët e radiologjisë e të stomatologjisë.

Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës është mbajtur "Java Botërore e Diabetit

Me 14 Nëntor në Sheshin "Zahir Pajaziti" në tend janë zhvilluar aktivitete për qytetarët e rastit: matja e glikemisë, këshilla dhe shpërndarja e materialit edukativ prej orës 09:00 - 13:00.

Ky aktivitet ka zgjat 4 ditë nga data 14.11.022 deri me datën 17.11.022

Me Datën 18.11.022 nga ora 07:00 Ecje në parkun e Gërmisë, pacientet që kanë qene të ftuar në Villa Gërmija, ju është matur glikemia dhe aktivitetet tjera edukativo shëndetësore

Angazhim rreth menaxhimit të kontratës Furnizimi me pajisje mjekësore.

Vizita në QKMF dhe QMF me menaxherin e kontratës për pastrim të objekteve, Angazhimet rreth Mekanizmin koordinues Komunal kundër dhunës në familje. Angazhimet rreth lëshimit të vertetimeve dhe qertifikatave për rilicensimin e infermiereve dhe profesionistë tjera shëndetësore.

Gjatë muajit Nëntor 2022 janë bërë këto postimi në fb dhe web faqe të QKMF-së;

1. Vizita e fëmijëve parashkollor ne QMF-8

Me datë 11.11.2022 ne QMF-8 ishin për vizitë grupi i fëmijëve parashkollor të SHFMU "Mehmet Gjevori".Grupi u prit nga menaxhmenti i njësisë, dr.Flutura Jusufi- stomatologe dhe ass.Mirjeta Babatinca.Duke qenë se kariesi i dhëmbëve mbetet një ndër sfidat kryesore, mirëpresim fëmijët në vizita të rregullta me qëllim trajtimin dhe parandalimin e kariesit.Shëndeti i tyre, është prioriteti ynë!

2. Dita e pare e javës se diabetit

Me datë 14 Nëntor në emër të Ditës Botërore të Diabetit QKMF-Prishtinë në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale për Shëndetësi, QKUK, IKSHP dhe Universitetet private të Komunës së Prishtinës filluan aktivitetet të cilat do të mbahen çdo ditë deri me datë 18 Nëntor ku edhe do të përmbyllet java kushtuar sëmundjes së diabetit. Ne sallën e QKMF-së Prishtinë u mbajt ligjërata edukative nga mjekët e repartit të endokrinologjisë/ QKUK për pacientët me Diabet me temën "Antidiabetikët oral dhe dhënja e insulinës" prej ores 08:00-09:00.

Në sheshin "Zahir Pajaziti" aktiviteti u mbajt nga studentët e Kolegjit Univerzum prej orës 09:00-13:00.QMF-9 dhe QMF-10 zhvilluan aktivitetin në SHFMU "Xhavit Ahmeti" dhe "Gjergj Fishta" në orët e mesdites.

QMF-8 mbajti aktivitetin në qendrën e qëndrimit ditor të të moshuarve në lagjen Pejton prej orës 14:00.

QKMF me trajnerët e QTMF-së ishin prezentë në shesh për edukim shëndetësor të qytetarëve të rastit.

3. Dita e dyte e javës së diabetit

4. Me datë 15 Nëntor në emër të Javës Botërore të Diabetit aktivitetet vazhduan në sallën e QKMF Prishtinë ku u mbajt pjesa e dytë e ligjëratës edukative nga mjekët e repartit të endokrinologjisë/ QKUK për pacientët me Diabet me temën: Ushqimi dhe aktiviteti fizik prej orës 08:00-09:00.

Në sheshin "Zahir Pajaziti" aktiviteti u mbajt nga studentët e Kolegjit AAB prej orës 09:00 -13:00.

QMF-6 dhe QMF-7 zhvilluan aktivitetin në SHFMU "Ismajl Qemajli " dhe "7 Marsi". QMF-11 vizitoi qendrën e qëndrimit ditor për të moshuar në lagjen Aktash prej orës 14:00.

QKMF me trajneret e QTMF-së ishin prezente në shesh për edukim shëndetësor të qytetarëve të rastit.

5. Dita e trete e javës së diabetit

Me datë 16 Nëntor në emër të Javës Botërore të Diabetit aktivitetet vazhduan në sallën e QKMF Prishtinë ku u mbajt pjesa e tretë e ligjëratës edukative nga mjekët e repartit të endokrinologjisë/ QKUK për pacientët me Diabet me temën: Vetëkontrolli tek të sëmurët me diabet prej orës 12:00-13:00.

Në sheshin "Zahir Pajaziti" aktiviteti u mbajt nga studentët e Kolegjit Heimerer prej orës 09:00 -13:00.

QMF-2 dhe QMF-Mati 1 zhvilluan aktivitetin në SHFMU "Hilmi Rakovica" dhe SHFMU "Pavarësia".

QMF-5 vizitoi Qendrën e qëndrimit ditor për të moshuar në lagjen Ulpiana prej orës 14:00.

QKMF me trajneret e QTMF-së ishin prezente në shesh për edukim shëndetësor të qytetarëve të rastit.

6. Ligjerata e ZHVP se për mjek

Me datë, 09.11.22 dhe 16.11.22 në kuadër të Programit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional në QKMF është mbajtur ligjerata me temë: "Obeziteti të fëmijët" Ligjëruese: Dr.Vjosa Mulliqi Kotori Pediater -Endokrinologe/QKUK
Në ligjeratë morrën pjesë 53 Mjekë nga QKMF.

7. Dita e katert e javës së diabetit

Me datë 17 Nëntor në emër të Javës Botërore të Diabetit aktivitetet vazhduan në sallën e QKMF Prishtinë ku u mbajt pjesa e katërt e ligjëratës edukative nga mjekët e repartit të endokrinologjisë/ QKUK për pacientët me Diabet me temën: Higjiena e trupit dhe kujdesi për shputat prej orës 12:00-13:00.

Në sheshin "Zahir Pajaziti" aktiviteti u mbajt nga studentët e Kolegjit Rezonanca prej orës 09:00 -13:00.

QMF-Hajvali dhe QMF-Mat zhvilluan aktivitetin në SHFMU "Shkëndija" dhe SHFMU "Mitrush Kuteli".

QMF-1 vizitoi qendrën e qëndrimit ditor për të moshuar në lagjen Tophane prej orës 14:00.

QKMF me trajneret e QTMF-së ishin prezente në shesh për edukim shëndetësor të qytetarëve të rastit.

8. Vizita e dyte e femijeve parashkollor ne QMF-8

Me datë 18.11.2022 ne QMF-8 ishin për vizitë grupi i dytë i fëmijëve parashkollor të SHFMU "Mehmet Gjevori".

Grupi u prit nga menaxhmenti i njësisë, dr.Flutura Jusufi- stomatologe dhe ass.Mirjeta Babatinca.

Duke qenë se kariesi i dhëmbëve mbetet një ndër sfidat kryesore, mirëpresim fëmijët në vizita të rregullta me qëllim trajtimin dhe parandalimin e kariesit.

Shëndeti i tyre, është prioriteti ynë!

9. Dita e peste dhe permbyllese e javes se diabetit

Me datë 18 Nëntor permbyllëm Javën Botërore të Diabetit me aktivitet të organizuar në Parkun e Germise. Ecja u realizua së bashku me pacientët me diabet nga pishina deri te Villa Germia ku u mbajt edhe ligjerata permbyllëse nga dr Drita Peqani- mjekje familjare. Aktivitetit ju bashkangjiten edhe Kryetari i Komunes së Prishtinës z Përparim Rama, drejtori i shëndetësisë dr Izet Sadiku, menaxhmeti i QKMF-së Prishtine, koordinatorja per edukim shëndetësor, trajneret e infermierisë dhe përfaqësues tjerë nga Komuna e Prishtinës.

Qellimi i aktivitetit të sotëm ishte promovimi i rëndësisë së aktivitetit fizik dhe ushqimit të shëndetshem për këta pacient.

Në sheshin "Zahir Pajaziti" u përmyll edhe aktiviteti në tendë për qytetarë realizuar nga studentët e Infermierisë së UP prej orës 09:00-13:00

Ky aktivitet u perkrah ne vazhdimesi nga trajneret e QTMF-së duke ofruar qytetarëve çdo ditë edukim, këshillim dhe promovim shëndetësore.

Vazhdimisht janë bërë vizita monitoruese (nga ne, shefat dhe infermieret përgjegjëse të njësisive) në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) dhe janë konstatuar të gjeturat vijuese:

Respektohen rregullat e përgjithshme, të gjithë ishin në vendet e tyre të punës, furnizimi me pajisje dhe masa mbrojtëse ishte i mirë, pra nuk është konstatuar ndonjë parregullsi. Në kuadër të vizitave monitoruese janë bërë vizita edhe nga Komisioni në nivel Komunal.

Paraqitet nevoja për inventarizim dhe gëlqerosje të hapësirave të punës. Po ashtu, vështirësi në organizimin e punës paraqet edhe mungesa e punëtorëve shëndetësorë (mjek, infermier).

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

I. Hyrje

Qendra e Mjekësisë Urgjente – Prishtinë, gjatë muajit Nëntor 2022, ka krye intervenime të pacientët urgjent. Kemi ofruar shërbime mjekësore sipas thirrjeve në linjën emergjente 194 duke zbatuar prioritetet sipas triazhës primare duke zbatuar protokollet e thirrjeve dhe urgjencave mjekësore paraspitalore.

II. Patologjia dhe shërbimet

Muajin Nëntor, kemi vazhduar punën për të ofruar intervenime urgjente mjekësore në kohën e duhur.

Nga raportimet e stafit mjekësor, ka dominuar patologjia me:

- Bronchite akute kronike
- Hipertension arterial
- Astma bronchiale
- Sëmundjet malinje (dominonon Ca e mushkërive, gjirit, zorrës trashë etj)
- Ulcera gastroduodenale
- Gjendje anxyoso -depressive
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut
- Syndroma lumbago
- Ataqe cerebrovaskulare
- Diabet mellitus me kriza hipoglikemike dhe hiperglikemike
- Artrite reumatike
- Cholecystite akute dhe kronike
- Gjendje febrile me konvulzione
- Ataqe epileptike
- Cefalea simptomatike
- Lendime nga sulmet fizike, etj.

Numri i rasteve është prezentuar në raportin, nga u.d. e SISH.

III. Edukimi i vazhdueshëm profesional

Me datën 25 Nëntor 2022 është mbajtur ligjerata me titull:

Satisfakcioni-pritshmëria dhe besueshmëria e pacientëve në marrjen e shërbimeve nga QMU në kushte paraspitalore

Lektore:Mr.sci.Arlinda Avdullahu-SMF

Ligjerata zgjoi vëmendjen e audiences u shtruan shumë pyetje dhe u zhvilluan diskutime rreth lësaj teme.

Salla ishte e mbushur me personel shëndetsor (mjek dhe infermier) ligjerata ka qen e akredituar nga Oda e mjekëve dhe Infermierëve të Kosovës.

#

IV. RAPORTI I SHËRBIMEVE MJEKËSORE NËNTOR, 2022, Ud. së SISH

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr	%
1	Intervenime mjekësore urgjente në teren	418	16.5
2	Vizita jo urgjente në teren	753	29.77
3	Vizita dhe observime me EKG në QMU	261	10.32
4	Shërbime infermierore	526	20.80
5	Aksidentet trafiku	68	2.69
6	Reanimime në teren	47	1.86
7	Transporte në QKUK	329	13.00
8	Lëndime aksientale	74	2.93
9	Konstatim vdekjeje	53	2.01
	Totali	2529	100

V. ZYRA E PROKURIMIT NË QMU

RAPORT PËR MUAJIN NËNTOR, 2022

❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësit kërkuese .
- Bashkëpunimi i zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në komunë dhe bashkëpunimi sipas UA/2016 të LPP me AQP për kyçje në kontratat e centralizuara.
- Sipas LPB bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranim të mallrave ,shërbimeve, caktimin e menaxhereve të kontratave etj. sipas nevojave të paraqitura.

❖ AKTIVITETET E ZBATUARA

- Me datën 03.11.2022.kompletimi i lëndës për Mirëmbajtjeje dhe servisim të kondicionerëve dhe përgatitja për pagesë.
- Me datën 04.11.2022.Kompletimi i lëndës për furnizim dhe montimi i kondicionerëve .
- Me datën 03.11.2022.Nxjerrja e UB në sistemin e FREE BALANCIT për Mirëmbajtjeje dhe servisim të kondicionerëve në QMU me shumë prej 500.00€

- Me datën 09.11.2022.Nxjerrja e UB në sistemin e FREE BALANCIT për Mirëmbajtjeje dhe servisim të kondicionerëve në QMU me shumë prej 65.00€
- Me datën 09.11.2022.Nxjerrja e UB në sistemin e FREE BALANCIT për Furnizim dhe montim të kondicionerëve me shumë prej 890.00€
- Me datën 07.11.2022.Nxjerrja e UB në sistemin e FREE BALANCIT për Shfrytëzimin e automjetit me qira me shumë prej 347.00€
- Me datën 08.11.2022 nxjerrja e Urdhër blerjes në sistemin e FREE BALANCIT për Shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qira me shumën 11.14 €
- Me datën 08.11.2022 nxjerrja e Urdhër blerjes në sistemin e FREE BALANCIT për Furnizim me O2 me shumën 74.97 €
- Me datën 10.11.2022. Punimi i DT për Furnizim me reagenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender dhe shpërndarja te OE.
- Me datën 11.11.2022. Hapja dhe vlerësimi i ofertave për Furnizim me reagenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender.
- Me datën 14.11.2022 Njoftim për Vendimin e AK për Furnizim me regjenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender
- Me datën 15.11.2022. Nënshkrimi i kontratës për Furnizim me regjenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender
- Me datën 16.11.2022. Njoftimi për Nënshkrimi i kontratës për Furnizim me regjenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender
- Me datën 16.11.2022 nxjerrja e Urdhër blerjes në sistemin e FREE BALANCIT për Furnizim me ujë për pije me shumën 99.60€
- Me datën 16.11.2022 nxjerrja e Urdhër blerjes në sistemin e FREE BALANCIT për Furnizim me reagenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender me shumën 497.00€
- Me datën 18.11.2022 nxjerrja e Urdhër blerjes në sistemin e FREE BALANCIT për Furnizim me karburante me shumën 2244.12 €
- Me datën 18.11.2022 nxjerrja e Urdhër blerjes në sistemin e FREE BALANCIT për Furnizim me receta me çmim 100.00 €
- Me datën 21.11.2022 kompletimi dhe përgatitja e lëndës për pagesë për Furnizim me reagenca dhe material shpenzues për laborator –ri tender.
- Nga data 21.11-30.11.2022 mbledhja e kërkesave nga njësit kërkuese në QMU për punimin e Planifikim paraprak të prokurimit për vitin 2023.

AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR

- **Punimi dhe dorëzimi i Planifikimit paraprak për vitin 2023 te ZKA i AK sipas LPP.**
- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës .

VI. ZYRA E FINANCAVE NË QMU RAPORTË MUJOR PËR MUAJIN NËNTOR, 01.11 deri 30.11. 2022

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Përgatitja e shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën Tremujore (TMIV- 2022) dhe Krahasimi i tyre me vitin Paraprak.
- Mbajtja e një takimi për mbarëvajtjen dhe raportimin e punëve të kryera gjatë kesaj periudhe.

AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA

- Përgatitja e lëndeve të poshtë shënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre .
- Shpënzimet e telefonit në QMU për muajin Tetor
- Shpënzimet e tel. në Xhemajl Ibish për muajin Tetor
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin Tetor
- Furnizim me ujë për pije për muajin Tetor
- Shfrytzimi i automjetit me qëra për muajin Tetor
- Furnizim me karburante për muajin Tetor
- Përgatitja e fakturave për mirëmbajtjen e autoambulancave
- Për muajin Tetor
- Furnizim me barna për muajin Tetor
- Furnizim me material shpenzus për muajin Tetor
- Mirëmbajtja e fotokopjës dhe printerave me qëra-për muajin Tetor
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të
- Lehonisë, largime nga puna etj.për muajin Nëntor
- Përgatitja e pagave për 2 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin Nëntor
- Përgatitja e Ndërrimeve të natës të muajit Tetor që dalin me
- Paga të muajit Nëntor

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPER**

- Kontrollimi i të gjitha pagesave që të kryhen në afate të parapara për pagesë
- Kontrollimi i arkës dhe të hyrave .

Faturat e lartëcekura janë të rregullta çdo muaj dhe duhet të përgatiten me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe të dërgohen në DSH për pagesë

Faturat e muajit Tetor vijnë prej datës 1-15 Nëntor dhe duhet të përgatiten për pagesë në muajin Tetor, me përjashtim të pagave dhe ndryshimeve në paga që janë për muajin Nëntor dhe të cilat duhet të skanohen dhe të dorzohen te Divizioni i Pagave. Ndryshimet në paga (pushime të lehonisë, pushim pa pagesë, ndërrim të xhirollogarisë etj.). Ndryshimet e natës për muajin Tetor përgatiten dhe dorzohen për pagesë në muajin Nëntor. Kjo është sa për sqarim.